

AKT THEMELIMI
DHE
STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“D COMPANY” SH.P.K.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar, themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "D Company" SHPK, veprimtaria e së cilës do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti.

KREU I

FORMA LIGJORE – EMERTIMI I SHOQERISE – SELIA – KOHEZGJATJA – OBJEKTI

Neni 1 – Forma Ligjore dhe Emertimi i Shoqerise

- 1.1 Shoqëria ka formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".
- 1.2 Emri i shoqerise eshte “**D Company**” SH.P.K (ketej e tutje referuar si “Shoqeria”).
- 1.3 Shoqeria ka vulen dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2- Selia

- 2.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Rr. Grigor Heba, N 11/6, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Shoqeria mund te hape apo mbylle filiale, dege dhe/ose zyra perfaqesimi ne Shqipëri apo jashte saj.

Neni 3 – Kohezgjatja e veprimtarise

- 3.1 Kohezgjatja e veprimtarise te Shoqerise eshte pa afat.
- 3.2 Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 4 – Objekti i Aktivitetit

- 4.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne:
 - Tregtim me shumicë dhe pakicë dhe import-eksport të: Mallra të ndryshme industrial, të konsumit, kancelari, ushqimore, etj; Makineri-paisje, pjese kembimi të ndryshme, etj.; Produkte dhe pajisje, kozmetike, parafarmaceutike, bimë medicinale, etj.
 - Ofrimi i shërbimeve për individë, persona fizikë dhe juridikë, shqiptarë e të huaj, si: Konsulencë në fusha të ndryshme si: ligjore, fiskale e financiare, manaxheriale, teknike, dhënie ekspertize dhe mbështetje me studime në fusha të ndryshme; Hartim, manaxhim dhe koordinim projektesh në fusha te ndryshme te biznesit, mjedisit, energjisë, ndërtimit, medias, etj; Aktivitete në fushen e panaireve, ekspozitave, konferencave, seminareve, eventve, B2B, etj; Aktivitete në fushëb e mediave, prodhimeve audiovizuale, marketingut dhe PR dhe shërbimet e lidhura me to.

- Ofrimin e shërbimeve të perfaqesimit, të ndermjetesimit, të agentit, brokerit, dhe shërbimeve të tjera ndihmëse, etj.
 - Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.
- 4.2 Në funksion të qëllimeve të mësipërme, Shoqëria mund të hyjë në tregje dhe operacione të ndryshme, të zotërojë pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe/ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera tregtare;
- 4.3 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshohet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve/Ortakut të vetëm.

KREU II

KAPITALI – KOUTAT – TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 5 – Kapitali

- 5.1 Kapitali i shoqërisë është 10'000 (dhjetemijë) Lekë. Kapitali është i pashlyer.
- 5.2 Ky kapital zotërohet nga Ortaku i vetëm i shoqërisë, Znj. Ermira Pogaçi, në masën 100.

Neni 6 - Kuotat

- 5.3 Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale 10'000 (dhjetë mijë) Lekë.

Neni 7 - Zmadhimi dhe Zvogëlimi i kapitalit

- 7.1 Asambleja e Ortakëve/Ortakut të vetëm mund të vendosë të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin në përputhje me interesin e shoqërisë dhe aktivitetit të saj si dhe dispozitat ligjore në fuqi të ligjit për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” Nr. 9901, datë 14.4. 2008, i ndryshuar.
- 7.2 Asambleja e Ortakëve/Ortakut të vetëm mund të vendosë në mënyrë unanime të përmbushë nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit ose financimeve (qofshin këto me fitim/interes ose jo), dhe në formën e investimeve në shoqëri në natyrë ose para, duke respektuar normat e transparencës dhe kërkesat të tjera me karakter fiskal.

Neni 8 - Koutat /Transferimi i Koutave

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të ndajë dhe pjestojë kuotat. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
- 8.2 Ortaku/et mund të transferojë lirisht kuotat e Shoqërisë tek ortakët e tjerë të shoqërisë, të trashëgimtarët, ose tek palë të treta, subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë.

KREU III

ORGANET E SHOQËRISË DHE VENDIMMARRJA

Neni 9 – Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimarrës i Shoqërisë dhe përbëhet nga të gjithë ortakët e Shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka të drejtën të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të shprehë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa kouta zoteron.

- 9.3 Çdo ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme nga nje person tjetër, jo domosdoshmerisht ortak, ne baze te nje prokure me shkrim. Ne çdo rast, prokura mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese te Pergjithshme, dhe eshte e vlefshme edhe per thirrjen e saj.
- 9.4 Asambleja e Pergjithshme mund te mblidhet ne nje vendndodhje te ndryshme nga selia e Shoqerise, brenda Republikes se Shqiperise ose jashte saj.
- 9.5 Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori sa here qe te jete e nevojshme per interesat e Shoqerise ose ne rast se kerkohet nga legjislacioni ne fuqi apo ortakët, te cilet zoterojne te pakten 5% (pese per qind) te kapitalit. Ne çdo rast, Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten nje here ne vit, me qellim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e bilancit vjetor te vitit ushtrimor te meparshem, dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj.
- 9.6 Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme duhet te behet me leter rekomande me njoftim marrjeje, te derguar ne adresen e ortakeve ose me poste elektronike ne adresen elektronike te ortakeve te pakten 21 (njetzet e nje) dite perpara dates se caktuar per mbledhjen e asamblese.
- 9.7 Njoftimi duhet te permbaje informacion mbi çështjet qe do te diskutohen dhe mbi te cilat do merret vendim, vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte, si edhe procedurat e detajuara te pjesemarrjes dhe te votimit, informacion mbi vendin dhe menytrat e marrjes se dokumentacionit dhe projekt vendimeve te asamblese si edhe elementet e tjera te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi.
- 9.8 Asambleja e Pergjithshme do te quhet e thirrur dhe e mbledhur rregullisht edhe nese nuk respektohen te gjitha formalitetet e thirrjes, nese te gjithë ortakët qe perfaqesojne te tere kapitalin e Shoqerise jane te pranishem ne mbledhje ose te perfaqesuar me prokure, dhe shprehen dakord per te zhvillur mbledhjen e asamblese pavaresisht parregullsive ne thirrjen e saj.
- 9.9 Asambleja e Pergjithshme mund te mbahet edhe me pjesemarrjen e personave ne vende te ndryshme, dhe mund te mbahet edhe me ane te telekonferences apo video conferences, ose mjete te tjera elektronike te ngjashme, me kusht qe te gjithë te pranishmit te mund te identifikohen dhe t'u jepet mundesia per te ndjekur diskutimet dhe per te marre pjese ne to.
- 9.10 Asambleja e Pergjithshme drejtohet nga administratori i shoqërisë ose nga çdo person tjetër i zgjedhur nga Ortakët/ Ortaku i vetëm i shoqërisë.
- 9.11 Drejtuesi i mbledhjes ka kompetenca te plota per te kontrolluar prokurat dhe rregullesine e tyre, te drejten e ortakeve dhe perfaqesuesve te tyre per te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme, dhe per te percaktuar nese asambleja eshte mbledhur rregullisht dhe nese eshte arritur kuorumi i domosdoshem per te marre vendime te vlefshme. Drejtuesi i mbledhjes ka gjithashtu te drejten per te drejtuar diskutimet dhe percaktuar metodat dhe procedurat e votimit.
- 9.12 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve, ku shënohet data, vendi, rendi i ditës, emri i drejtuesit të mbledhjes dhe mbajtësit të procesverbalit, çështjet kryesore dhe vendimet e marra. Procesverbali nënshkruhet nga Drejtuesi i mbledhjes dhe Sekretari (mbajtësi i procesverbalit).
- 9.13 Ne rast se Shoqeria mbetet vetem nje ortak, i cili zoteron te tere kapitalin e Shoqerise, vendimet e marra do te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen apo fshihen.

Neni 10 – Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

- 10.1 Ne rast vendimesh qe kerkojne shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket qe zoterojne me shume se 30% (tridhjetë për qind) te kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30 (tridhjetë) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e zakonshme merren me voten pro te shumices se ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.
- 10.2 Asambleja e Pergjithshme ka kompetenca dhe mund te marre vendime te zakonshme mbi çështjet e mëposhtme:
- (a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - (b) emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
 - (c) Emerimin dhe shkarkimin e administratorit/ve dhe percaktimin e kompetencave dhe kufizimeve te tij/tyre;
 - (d) miratimin e shperblimeve per personat e permendur ne paragraf (b) dhe (c);
 - (e) destinimin e fitimit dhe shperndarjen ose jo te tij si dhe miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - (f) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne proceset gjyqesore ndaj anetareve Administratoreve;
 - (g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë,
 - (h) hapjen e adresave dytesore si dhe hapjen, blerjen apo shitjen e nje dege, filiali, zyre perfaqesimi;
 - (i) çdo çështje tjetër të përcaktuar në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi si dhe nga ky Statut.
- 10.3 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, Asambleja e Pergjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.
- 10.4 Ne rast vendimesh te jashtezakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket qe zoterojne me shume se 70% (shtatedhjetedhjetë për qind) te aksioneve me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30 (tridhjetë) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e jashtezakonshme merren me voten pro te te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.
- 10.5 Asambleja e Pergjithshme ka kompetenca dhe mund te marre vendime te jashtezakonshme mbi çështjet e mëposhtme:
- (a) plotesimi dhe ndryshimi i dispozitave të statutit,
 - (b) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit,
 - (c) pjesmarrje ne shoqeri te tjera, brenda apo jashte vendit, krijimin e joint venture, investime apo financime te ndryshme ne tregje, projekte, etj;
 - (d) ndryshimet ne te drejtat qe lidhen me koutat ose çdo riblerje, blerje ose çdo fitim tjetër nga Shoqeria te çdo kuote apo garancive te tjera te Shoqerise
 - (e) riorganizimin, shperndarjen, transformimin, bashkimin, ndarjen, shkrirjen, prishjen dhe likuidimin e Shoqerise, si edhe riorganizimin e Shoqërisë ne nje forme tjetër ligjore;
 - (f) mbyllja dhe shpërndarja e parakohshme e Shoqërisë;
 - (g) ndermarrjen e çdo veprimi, i cili pritet ne menyre te arsyeshme se do te çojë ne likuidimin e Shoqerise;

- (h) çdo çështje tjetër të përcaktuar në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi si dhe nga ky Statut.
- 10.6 Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm.

Neni 11 – Administratori i Përgjithshëm

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme emeron një (1) personë fizik si Administrator të Përgjithshëm të Shoqërisë, i cili mund të jetë ortak ose jo dhe që do të jetë përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë sipas kufizimeve të parashikuara nga ligji në fuqi dhe nga ky Statut.
- 11.2 Administratori emërohet për një afat tre (3) vjeçar dhe mund të rizgjidhet.
- 11.3 Shoqëria merr angazhime me nënshkrimin e vetëm të Administratorit, sipas kufizimeve të parashikuara nga ligji në fuqi dhe nga ky Statut.
- 11.4 Administratori i Shoqërisë duhet t'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme.
- 11.5 Administratori i Shoqërisë ka të drejtën dhe detyrimin për të përfaqësuar Shoqërinë në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe ligji në fuqi.
- 11.6 Administratori i parë që do të drejtojë Shoqërinë është Znj. Ermira Pogaçi, identifikuar nëpërmjet Nr.personal I55119022P, e cila emërohet për 3 vite.

Neni 12 – Eksperti kontabel i autorizuar

- 12.1. Kur shoqëria plotëson kushtet sipas legjislacionit shqiptar fiskal dhe ka detyrim për auditim të brendshëm të pasqyrave financiare, Asambleja e Përgjithshme emeron për një vit financiar një ose më shumë eksperte kontabel të autorizuar për Auditimin e saj.

KREU IV

VITI FINANCIAR, FITIMET

Neni 13 – Viti financiar

- 13.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.
- 13.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 14 – Fitimet

- 14.1 Fitimet që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore, pasi të jetë zbritur rezerva ligjore dhe pasi të jenë zbritur të gjitha shumatat të cilat Asambleja e Përgjithshme ka vendosur të lere menjëherë si fonde të destinuar për investime apo rezerva për shoqërinë, i shpërndahen ortakëve me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 14.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të krijojë rezerva të tjera të jashtëzakonshme ose specifike.
- 14.3 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, shoqëria mund të vendosë të mos shpërndajë fitime duke respektuar rregullat e vendosura në pikën 11.2 të këtij Statuti

KREU V

PRISHJA – NDARJA – BASHKIMI, LIKUIDIMI

Neni 15 – Riorganizimi i Shoqerise, Ndarja - Bashkimi

- 15.1 Shoqeria mund te mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me shoqëri tjetër, nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore, me vendim te Asamblese se Ortakeve sipas parashikimeve te ketij statuti dhe dispozitave te zbatueshme te Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Neni 16 – Prishja – Likuidimi

- 16.1 Shperndarja apo prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:
- (a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise;
 - (b) Me vendim te Asamblese se Pergjithme te Ortakeve;
 - (c) Me hapjen e procedurave te falimentit;
 - (d) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2(dy) vjet dhe eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me prashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar;
 - (e) Me vendim Gjykate;
 - (f) apo cdo rast tjetër te parashikuara ne Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
- 16.2 Ne kete rast prishja e Shoqerise vendoset dhe kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij Satuti dhe kerkesave ligjore ne fuqi. Asambleja e Pergjithshme do te marr vendim per emerimin e likudatorit/ve.
- 16.3 Procedura e likuidimit te Shoqerise do te kryhet ne perputhje me kerkesat ligjore ne fuqi.

KREU VI

TE NDRYSHME

Neni 17 – Gjuha

- 17.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut eshte hartuar ne 4 (kater) kopje te njejta ne gjuhen shqipe.

Neni 18 – Dispozita Perfundimtare

- 18.1 Çeshtjet qe nuk parashikohet shprehimisht nga ky Akt Themelimi dhe Statut do te rregullohen nga Ligji Nr. 9901, Date 14.4.2008, per “Tregtarete dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar.

* * * * *

ORTAKU I VETËM THEMELUES

ERMIRA POGAÇI

Tirane, me 16.1.2025